



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

VENDIM

Nr. 84 date 12.12.2024



KËSHILLIT BASHKIAK GJIROKASTËR

VENDIM

**“PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR OSE
FONDIT TË BUXHETIT VENDOR, MBI PROGRAMIN E BLLOK-NDIHMËS
EKONOMIKE DERI NË 6% (PËRQIND) PËR VITIN 2025”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Këshillit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë të cilat do të trajtohen me fondin e kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% (përqind) ose fondin e buxhetit vendor, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

